



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 12461 Prot.

Vlorë më 16.10. 2023

**PROJEKT – VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2023

**“PËR EMËRTIM RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË VLORË”**

Bazuar në nenin 8, nenin 9/1, pika 1.1/b, pika 2, 9, nenin 54 gërmë “ll”, nenin 55 pika 2, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe në relacionin e paraqitur nga grupi i këshilltarëve të PD, në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_ 2023,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë emërtimin e rrugës “Elham Sulejman Elezaj”, e cila është pjesë e blloku të banimit, të kufizuar nga rrugët: Bulevardi “Ismail Qemali”, Rruga “Transballkanike”, Rruga “Hasan Kushta” dhe Rruga “Gjergj Araniti”, në Lagjen “Pavarësia”, sipas planvendosjes bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

**GRUPI I KËSHILLTARËVE TË PARTISË DEMOKRATIKE**

KRYETARI  
Gjergji NIKA



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 12461 Prot.

Vlorë më 16.10. 2023

### RELACION

#### MBI PROJEKT-VENDIMIN PËR EMËRTIM RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË VLORË “RRUGA ELHAM SULEJMAN ELEZAJ”

Elham Sulejman ELEZAJ lindi në fshatin Hysovardhë të Vlorës, më datë 27.07.1969. Arsimin e mesëm e mbaroi në vitin 1989, në Shkollën e Mesme Bujqësore “Equerem Beqiri” në Kotë, të Vlorës. Ka kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak në vitet 1989-1991.

Më datë 16.11.1992 ka filluar punë në strukturat e Policisë së Shtetit, fiilimisht si shofer i trupës operacionale në Repartin “RENEA”, dhe më pas në repartin Special “77”, si polic i trupës speciale.

Për aftësitë e spikatura dhe punën e tij shëmbullore, u vlerësua dhe iu dha e drejta për të vazhduar studimet e larta në Akademinë e Rendit Publik, duke e përfunduar atë me sukses.

Pas përfundimit të studimeve të larta u më datën 11.05.1997 u emërua oficer policie, dhe mori detyrën Komandant Grupi në repartin RENEA, në Tiranë. Cilësitetë e tij të spikatura si, guximi, kurajoja dhe përkushtimi e bënë atë një figurë të njojur në shoqëri dhe në institucionin ku punonte.

Ai ka lënë gjurmë të pashlyera tek të gjithë ata që e njihnin në veprimtarinë e tij si polic e më pas si oficer i trupës speciale, duke qenë i pari në çdo front ku ishte rreziku.

Elham ELEZAJ ka shpalosur me devotshmërinë e tij, cilësitetë e një ushtaraku atdhetar, trim, i gatshëm për të sakrifikuar edhe veten për të mbrojtur institucionet shtetërore, si dhe në luftën pa kompromis kundër aktivitetit kriminal. Ai kishte primare sigurinë e jetës dhe pronës së qytetarëve.

Për aftësitë e tij të veçanta, në vitin 1997, punonjësit të policisë Elham ELEZAJ iu ngarkua sigurimi i godinës së ministrisë së Brendshme, ringritja e komisariateve të policisë të shkatërruara nga trazirat të atij viti, si dhe rivendosja e sigurisë publike në rrethet Korçë, Pogradec, Berat, Burrel, Shkodër, Elbasan dhe në qytete të tjera.

Theksojmë se, eksperienca dhe formimi i tij si kuadër arriti nivele të larta në shërbimet e mëpasme, ku në grupin që drejtonte ka luajtur rol kryesor në shpartallimin e bandave kriminale të rrezikshme në qytetin e Vlorës, Cërrikut dhe Shkodrës, duke mundësuar kapjen dhe arrestimin e personave me rrezikshmëri të theksuar shoqërore.

Në 9 korrik të vitit 1998 Forcat RENEÀ u njoftuan se në një zonë të Tiranës, një person kishte marrë peng pjesëtarët e një familje, mes të cilëve gra dhe fëmijë. Atë ditë Elham ELEZAJ ishte i gatshëm, ishte dita e fundit në atë detyrë, pasi ishte emëruar shef komisariati në Sarandë, dhe të nesërmen e asaj dite, më 10 korrik do të paraqitej në detyrën e re.

Elhami shkoi në aksion dhe u bashkua me kolegët për lirimin e personave që mbaheshin peng. Operacioni zgjati disa orë, dhe gjatë këtij operacioni për humbi jetën në krye të detyrës punonjësi i Policisë së Shtetit, Elham ELEZAJ, në moshën 29-vjeçare.

Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut”, me Vendimin nr. 15, datë 31.10.2003, i ka akorduar ish punonjësit të Policisë së Shtetit z. Elham Sulejman ELEZAJ statusin “Dëshmor i Atdheut”, dhe familjes së tij i dha simbolin “Familje e Dëshmorit të Atdheut”.

Referuar sa më sipër, propozojmë që, në nderim të z. Elham Sulejman ELEZAJ “Dëshmor i Atdheut”, i rënë në krye të detyrës, një rrugë në territorin e bashkisë Vlorë të emërtohet “**Ruga Elham Sulejman Elezaj**”.


Vlerësojmë se është në nderin e Këshillit të Bashkisë të miratojë këtë projekt-vendim për një personalitet që me aktin sublim të dhënies së jetës në krye të detyrës, i jep nder jo vetëm Vlorës, por gjithë Shqipërisë.

#### **GRUPI I KËSHILLTARËVE PARTISË DEMOKRATIKE**

##### **KRYETARI**

Gjergji NIKA





Ruga e propozuar, me gjatesi 90 m ndodhet ne Lagjen "Pavaresia", prane bllokut te banimit te kufizuar nga rruget "Bulevardi Ismail Qemali", rruga "Transballkanike", rruga "Hasan Kushta" dhe rruga "Gjergj Aranitit"

DREJTORIA E  
URBANISTIKËS

## PLANVENDOSJE E RRUGES SE PROPOZUAR

BASHKIA VLORE 2023

A-01